STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 18 dhjetor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON ZGJATJEN E PROGRAMIT TË NDIHMËS SË EMERGJENCËS 'STEP'

Afati përfundimtar i programit Strehimi dhe Energjia Thelbësore e Përkohëshme zgjatet deri më 31 dhjetor 2012

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se afati përfundimtar për të bërë kërkesë për programin Strehimi dhe Energjia Thelbësore e Përkohëshme (STEP) është zgjatur deri më 31 dhjetor 2012 për Qytetin e Nju Jorkut (New York City) dhe qarqet Safolk (Suffolk) dhe Naso (Nassau). Programi STEP siguron ndihmë të emergjencës për rikthimin e përkohëshëm të elektricitetit, ngrohjes dhe ujit të ngrohtë në shtëpitë që mund të stehojnë pronarët e shtëpive ndërsa vazhdon puna për riparimet e përherëshme.

"Programi STEP është krijuar për të lejuar që familjet të qëndrojnë në shtëpitë e tyre ndërsa bëhen riparime të emergjencës ose elektrike," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Ndërsa banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) vazhdojnë të rimëkëmben nga dëmi i shkaktuar nga Uragani Sendi (Sandy), zgjatja e këtij programi do të lejojë më shumë familje që të marrin ndihmën e emergjencës që u nevojitet në mënyrë që të rindërtojnë dhe përsëri të kenë shtëpinë e tyre."

Afati përfundimtar tani është zgjatur për të marë formularët për sigurimin e të Drejtës për Hyrje (Right of Entry) (ROE) për programin, që ofron alternativat e mëposhtme:

• Riparimet e matësit elektrik të banesës – Për ata shtëpia e të cilëve mund të përdoret si një vend-strehimi dhe ka nevojë vetëm për riparime të matësit elektrik që të rivendoset energjia. Kjo mund të përfshijë riparime të kokës së mbrojtjes nga moti, të kabllit të shërbimit ose të prizës së matësit.

• Masa thelbësore të strehimit – Për ata shtëpia e të cilëve mund të përdoret si një vend-strehimi, STEP do të sigurojë elektricitet, ngrohje dhe ujë të ngrohtë të përkohëshëm për të përmbushur nevojat thelbësore të jetesës ndërsa bëhen riparime të përherëshme.

• Riparime të shpejta të përkohëshme të pjesës së jashtme – Këto janë riparime të nevojshme dhe thelbësore për të mbrojtur banesat e dëmtuara nga stuhia nga dëmi i metejshëm që mund të paraqesë një kërcënim të menjëhershëm ndaj jetës dhe pronës dhe, atje ku është e përshtatshme, të lehtësojë

strehimin në vend në pritje të riparimeve që janë më të përherëshme. Kjo mund të përfshijë sigurimin e dritareve të thyera, mbulimin e mureve të jashtëm e çative të dëmtuara dhe mbylljen e sigurimin e dyerve të jashtme të dëmtuara.

Banorët e Qarkut Safolk (Suffolk County) që dëshirojnë të marrin pjesë në Programin STEP duhet të telefonojnë në 2-1-1 për të caktuar një takim për një vlerësim të shtëpisë së tyre. Banorët që kanë nevojë për ndihmë nëpërmjet Programit STEP të Qarkut Naso (Nassau County) duhet të telefonojnë në 1-888-684-4267. Banorët në pesë distriktet e Qytetit të Nju Jorkut (New York City) mund të telefonojnë në 3-1-1 për të marë informacion në lidhje me programin. Pasi vlerësimi të përfundojë, sfera e punës do të përcaktohet dhe do t'i komunikohet pjesëmarrësit në program. Administratori i programit do të planifikojë për një kontraktor për të kryer punën që nevojitet në pronën e banimit. Puna duhet të përfundojë brenda gjashtëdhjetë ditësh nga vlerësimi i shtëpisë.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418